



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1091/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuëse (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Shaqir Totaj, kandidat për Kryetar të Komunës së Prizrenit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa me shenjë ZL.Anr.1091/2017, e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuëse (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Shaqir Totaj, kandidat për Kryetar të Komunës së Prizrenit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave.

## A r s y e t i m

Me datën 19.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuëse (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se Shaqir Totaj, kandidat për Kryetar të Komunës së Prizrenit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, ka thyer heshtjen zgjedhore, pasi që me datë 18.11.2017 në orën 1:39, në profilin e tij në facebook ka shpërndar një shkrim me titull “Pesë arsytet se pse duhet votuar Shaqir Totaj për kryetar të Prizrenit” dhe këtij shkrimi i ka bashkangjitur mbishkrimin #ShaqirTotaj# Forca e ndryshimit #PDK94). Sipas parashtruesit të ankesës ky veprim bie ndesh me nenin 36 të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës: 21.11.2017, subjekti politik PDK, ankesën e parashtuar nga BIRN dhe IKS e konsideron si të pabazë, për faktin se koha kur është bërë postimi nuk është brenda periudhës së heshtjes zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoi ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

## **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e Shaqir Totaj, kandidat për Kryetar të Komunës së Prizrenit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, Paneli i vlerësoi se janë të pa qëndrueshme dhe si të tillë e refuzoj ankesën, për faktin se nga shkresat e lëndës, nuk mund të vërtetohet se Shaqir Tolaj, kandidat për Kryetar të komunës së Prizrenit nga subjekti politik PDK, ka bërë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore, pasi që nga fotografitë e ofruara si provë shihet se postimi është bërë me datë 18.11.2017 në orën 1:39, kohë kur ende nuk ka filluar periudha e heshtjes zgjedhore, përkatësisht disa orë para fillimit të heshtjes zgjedhore, pra ky rast nuk përbën shkelje të nenit 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së ku përcaktohet se: *“Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.*

Andaj në mungesë dëshmive të qarta dhe bindëse siç kërkohen me nenin 117 dhe bazuar nenin 118.1 të LZP-së Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.Anr.1091/2017 me datën 21.11.2017



**Kryesues i Panelit**  
Hasan Shala

### ***Udhëzim Juridikë:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*